

# Raporti i Monitorimit të RAP në Kosovë

## Menaxhimi i Financave Publike

2024/2025



Group for Legal  
and Political  
Studies



**Publikimi:**

**Raporti i Monitorimit të RAP në Kosovë  
Menaxhimi i Financave Publike  
2024/2025**

**Publikuesi:**

**Grupi për Studime Juridike dhe Politike, (GLPS)**

**Autorët:**

**Blerina Istrefi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtina  
Elona Kurti, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtina**

**Dizajni:**

**2vo**

I.	RRETH WEBER	4
II.	FALËNDERIME	5
III.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
IV.	LISTA E SHKURTESAVE DHE E AKRONIMEVE	8
V.	I. WEBER RAP MONITOR: ÇFARË MONITOROJMË DHE SI?	9
VI.	II. TRANSPARENCA DHE QASJA E HAPUR E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE	16
VII.	II.3 TRANSPARENCA DHE KONKURUESHMËRIA NË SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK	24
VIII.	II.4 QASJA E HAPUR DHE TRANSPARENCA E PUNËS SË INSTITUCIONIT SHTETËROR TË AUDITIMIT	29
IX.	KRAHASIMI I PIKËVE TË PËRGJITHSHME NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE	32
X.	II.5 REKOMANDIMET NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE	32
XI.	SHTOJCA E METODOLOGJISË	35
XII.	LISTA E BURIMEVE TË REFERUARA NË KËTË RAPORT	42

## RRETH WEBER 3.0

Duke u mbështetur në arritjet e projekteve paraprake WeBER (2015–2018) dhe WeBER 2.0 (2019–2023), projekti **Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0** përfaqëson grantin e tretë radhazi të financuar nga Bashkimi Evropian të iniciativës më të madhe të udhëhequr nga shoqëria civile për monitorimin e reformës së administratës publike (PAR) në Ballkanin Perëndimor. Periudha e zbatimit të projektit është nga shkurti 2023 deri në korrik 2026. Të udhëhequr nga Parimet e SIGMA/OECD, dy fazat e para të iniciativës hodhën themelet për ambicien e WeBER 3.0 **për të fuqizuar më tej organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që të kontribuojnë në administrata më transparente, më të hapura, më të përgjegjshme, të orientuara drejt qytetarëve dhe, rrjedhimisht, më të harmonizuara me standardet e Bashkimit Evropian në rajonin e Ballkanit Perëndimor.**

WeBER 3.0 vazhdon të promovojë rolin thelbësor të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Reformën e Administratës Publike (PAR), duke avokuar njëkohësisht për përfshirje më të gjerë të qytetarëve në këtë proces dhe për masa reformuese gjithëpërfshirëse, të përshtatura sipas nevojave të përdoruesve, të cilat çojnë në përmirësime konkrete. Duke i mbështetur veprimet në të dhëna dhe analiza të qëndrueshme monitoruese, WeBER 3.0 do të fuqizojë shoqërinë civile që të ndikojë më efektivisht në hartimin dhe zbatimin e Reformës së Administratës Publike. Për të nxitur hartimin bashkëpunues të politikave dhe për të kapërcyer hendekun ndërmjet aspiratave dhe zgjidhjeve të zbatueshme, projekti do të lehtësojë dialog të qëndrueshëm politik ndërmjet qeverive dhe OSHC-ve përmes Platformës WeBER dhe Grupeve Kombëtare të Punës për PAR. Së fundmi, përmes granteve të vogla për OSHC-të lokale, WeBER 3.0 forcon angazhimin në nivel lokal në PAR, duke fuqizuar zërat e qytetarëve – përfituesit përfundimtarë të punës së administratave publike.

Produktet e WeBER 3.0 dhe informacione të mëtejshme rreth tyre janë të disponueshme në faqen zyrtare të projektit në adresën [www.par-monitor.org](http://www.par-monitor.org).

WeBER 3.0 zbatohet nga Think for Europe Network (TEN), i përbërë nga gjashtë institute kërkimore (think tanks) të orientuara drejt politikave të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Përmes partneritetit me Qendrën për Kërkime në Administratën Publike (Centre for Public Administration Research – KDZ) nga Vjena, WeBER 3.0 ka siguruar dukshmëri në nivel të Bashkimit Evropian.

## FALËNDERIME

Ashtu si në edicionet e mëparshme të raporteve kombëtare të Monitorit PAR, të publikuara për periudhat 2017/2018, 2019/2020 dhe 2021/2022, falënderime të veçanta u drejtohen anëtarëve të Platformës WeBER dhe Grupit Kombëtar të Punës në Kosovë, si dhe palëve të tjera të interesit në Kosovë që ndanë përvojat e tyre përmes intervistave, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në cilësinë e këtij raporti. Për të mbrojtur anonimitetin e tyre, ata nuk janë identifikuar individualisht në këtë raport.

Ekipi i WeBER 3.0 dëshiron gjithashtu të falënderojë partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë, të cilët kanë mbështetur projektin në fushën e kërkimit dhe në aktivitete të tjera. Në veçanti, falënderimi u drejtohet SIGMA/OECD (Support for Improvement in Governance and Management),<sup>1</sup> ReSPA (Regional School of Public Administration), si dhe Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si bashkëpunëtorë të projektit.

---

<sup>1</sup> Një nismë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe OECD-së.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vlerësimi i transparencës dhe qasjes së hapur së menaxhimit të financave publike përqendrohet në katër aspekte kyçe: 1) përfshirja dhe transparenca e procesit të hartimit të buxhetit, 2) disponueshmëria dhe gjithëpërfshirja e dokumentacionit buxhetor, 3) transparenca dhe konkurrueshmëria e sistemit të prokurimit publik, dhe 4) qasja e hapur dhe transparenca e punës së institucioneve supreme të auditimit. Aspekti i parë shqyrton shkallën në të cilën procesi i hartimit të buxhetit është përfshirës dhe transparent, duke siguruar qasje në kohë në informacion, mundësi formale për pjesëmarrje dhe përfshirje proaktive të qytetarëve dhe palëve të tjera të jashtme të interesit nga ana e institucionit përkatës. Aspekti i dytë fokusohet në transparencën dhe cilësinë e dokumentacionit buxhetor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor, duke vlerësuar nëse përfshihen projeksione afatmesme, ndikimet e politikave dhe të dhëna të detajuara për shpenzimet, si dhe duke shqyrtuar publikimin në kohë dhe qasshmërinë e dokumenteve buxhetore.

Kur bëhet fjalë për sistemin e prokurimit publik, theksi vihet në shqyrtimin nëse korniza politike, ligjore dhe institucionale promovon procedura të hapura dhe të drejta, nëse këto procedura zbatohen në praktikë dhe nëse prokurimet janë konkurruese dhe raportohen rregullisht. Së fundi, aspekti i fundit i kushtohet vlerësimin nëse institucionet supreme të auditimit angazhohen në komunikim dhe bashkëpunim aktiv me palët e jashtme të interesit, si dhe nëse sigurojnë publikim të rregullt dhe të qasshëm të aktiviteteve dhe raporteve të auditimit, në formate të hapura dhe të kuptueshme për përdoruesit. Gjetjet e këtij raporti pasqyrojnë periudhën që nga publikimi i PAR Monitor 2021/2022, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2022 e deri në fund të vitit 2024.<sup>2</sup>

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të sistemit të Menaxhimit të Financave Publike në Kosovë, duke analizuar transparencën e procesit buxhetor dhe të prokurimit publik, si dhe nivelin e llogaridhënies përmes Institucionit Suprem të Auditimit. Monitorimi ka shqyrtuar kornizën ligjore dhe dokumentet zyrtare të institucioneve publike, por fokusi kryesor ka qenë në mënyrën se si këto rregulla zbatohen në praktikë dhe në ndikimin e tyre në sigurimin e përdorimit të duhur të fondeve publike. Rezultati i përgjithshëm i Kosovës në këtë vlerësim është 52.5 nga 100 pikë, çka pasqyron një nivel mesatar të transparencës, me progres të dukshëm në disa fusha, por me boshllëqe të mëdha në zbatimin e plotë. Kosova tregon rezultate të pjesshme sa i përket përfshirjes dhe transparencës në procesin e përgatitjes së buxhetit. Edhe pse korniza strategjike dhe rregullative parasheh angazhimin e palëve të interesit dhe konsultime publike, ndikimi real i publikut në vendimmarrje mbetet i kufizuar, afati për komente është i shkurtër

<sup>2</sup> Për 2022, përfshihen vetëm zhvillimet që nuk janë pasqyruar nga PAR Monitor 2021/2022.

dhe perceptimi i qytetarëve për gjithëpërfshirjen mbetet i ulët. Transparenca në këtë fazë është më shumë formale sesa përmbajtësore.

Është arritur progres në publikimin dhe gjithëpërfshirjen e dokumenteve buxhetore, veçanërisht sa i përket qasjes në raportet e ekzekutimit të buxhetit, të cilat zakonisht publikohen me kohë. Megjithatë, dokumentet ende nuk ofrojnë shpjegime të detajuara mbi prioritetet e qeverisë dhe ndikimin e buxhetit, mungon informacioni për investimet kapitale, ndërsa të dhënat ende nuk publikohen në format të hapur, duke kufizuar analizën e pavarur. Kjo do të thotë se transparenca është rritur, por cilësia dhe qartësia e informacionit ende nuk e arrijnë nivelin e nevojshëm për llogaridhënie efektive. Ndërkohë, Institucioni Suprem i Auditimit vazhdon të mbetet një nga pikat më të forta të sistemit të financave publike në Kosovë. Raportet e auditimit publikohen rregullisht dhe janë lehtësisht të qasshme për publikun, duke kontribuar në rritjen e transparencës në përdorimin e parasë publike. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se transparenca në menaxhimin e financave publike është rritur në aspekt formal, por kjo jo gjithmonë përkthehet në llogaridhënie efektive dhe përdorim të duhur të burimeve publike. Ekziston një hendek i qartë ndërmjet rregullave të vendosura dhe zbatimit të tyre në praktikë, veçanërisht në prokurim dhe në shpjegimin e ndikimit të shpenzimeve buxhetore.

## LISTA E SHKURTESAVE DHE E AKRONIMEVE

MSHP – Menaxhimi i Shërbimeve Publike

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

MEAT – Tenderi më i favorshëm ekonomikisht

FOI – Liria e informimit

IK – Informatorët kyç

RAP – Reforma e Administratës Publike

ReSPA – Shkolla Rajonale e Administratës Publike

SIGMA – Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit

TEN – Rrjeti “Think for Europe”

WeBER – Projekti për Munësimin e Shoqërisë Civile në monitorimin e Reformës së Administratës Publike në Ballkanin Perëndimor.

# I. WeBER RAP Monitor: Çfarë monitorojmë dhe si?

## I.1 Qasja e WeBER-it në monitorimin e RAP

Metodologjia e Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP Monitor) është zhvilluar gjatë viteve 2015–2016, si pjesë e Projektit të parë “Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform” (WeBER). Që nga fillimi, WeBER ka adoptuar një qasje thellësisht të bazuar në dëshmi, me synimin për të rritur rëndësinë, pjesëmarrjen dhe kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor për të avokuar dhe ndikuar në hartimin dhe zbatimin e Reformës së Administratës Publike. Metodologjia RAP Monitor përbën një produkt kyç të WeBER-it, duke mundësuar monitorimin e Reformës së Administratës Publike nga shoqëria civile, të bazuar në fakte dhe analiza.

Në përputhje me fokusin e WeBER-it në procesin e anëtarësimit në BE të vendeve të rajonit, pas rishikimit të Parimeve të Administratës Publike të SIGMA-s në vitin 2023, metodologjia e WeBER RAP Monitor u ridizajnuua gjithashtu në vitin 2024, duke u mbështetur në këto Parime,<sup>3</sup> dhe në Metodologjinë e SIGMA-s,<sup>4</sup> si dhe duke plotësuar monitorimin e realizuar nga SIGMA me vëzhgime shtesë të fokusuar në transparencë, gjithëpërfshirje, qasje e hapur dhe aspekte të tjera të punës së administratës shtetërore, varësisht nga fusha përkatëse e Reformës së Administratës Publike (RAP). Ky rishikim ndihmon në ruajtjen e fokusit të rekomandimeve të WeBER-it në reforma që janë në përputhje me standardet e BE-së, duke udhëzuar kështu qeveritë e rajonit drejt një procesi të suksesshëm të anëtarësimit dhe anëtarësisë së ardhshme në Bashkimin Evropian. Ndryshimet kryesore në metodologjinë e rishikuar të RAP Monitor paraqiten shkurtimisht më poshtë.<sup>5</sup>

**Tabela 1.** Ndryshimet kryesore në Metodologjinë e Monitorimit të RAP

### Struktura

Për të qenë në përputhje me qasjen e re metodologjike të SIGMA-s, janë prezantuar ndryshimet strukturore në vijim:

- Prezantimi i një indikatorit të vetëm për secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP), i ndarë në nën-indikatorë, të cilët përbëhen më tej nga disa elemente të nën-indikatorëve (p.sh. kritere specifike që vlerësohen), me qëllim thjeshtësimin e qasjes dhe theksimin e fokusit në transparencë, gjithëpërfshirje dhe qasje të hapur në secilën fushë të RAP-it.

3 OECD (2023), Parimet e Administratës Publike, Publikuar OECD, Paris, <https://doi.org/10.1787/7f5ec453-en>.

4 I disponueshëm në: <https://www.sigmaweb.org/en/publications/documents/2024/assessment-methodology-of-the-principles-of-public-administration.html>.

5 Për informata të detajuara mbi fushëveprimin dhe procesin e rishikimit të metodologjisë, shih: <https://www.par-monitor.org/par-monitor-methodology/>.

- Prezantimi i llojeve të elementeve të nën-indikatorëve, duke siguruar që të mbulohen të gjitha aspektet e reformës, si në vijim:
  1. Strategjia dhe politikat,
  2. Legjislacioni,
  3. Struktura institucionale,
  4. Praktika në zbatim, dhe
  5. Rezultatet dhe ndikimi.
- Prezantimi i një shkalle vlerësimi me 100 pikë, për një vlerësim më të detajuar të progresit në secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP).

### Burimi i të dhënave

- Prezantimi i intervistave me “informatorë kyç”, përkatësisht akterë kryesorë jo-shtetërorë të angazhuar dhe të njohur me proceset. Këto intervista shërbejnë si burim i të dhënave për elementet “Rezultatet dhe Ndikimi”, duke zëvendësuar anketën e mëparshme me organizatat e shoqërisë civile.
- Përdorimi më sistematik i rezultateve të anketave të perceptimit publik si burim i të dhënave për elementet “Rezultatet dhe Ndikimi”, si dhe zgjerimi i fushëveprimit të anketës për të plotësuar vlerësimin në pesë fusha të Reformës së Administratës Publike (RAP), me përjashtim të fushës “Strategjia për RAP”.
- Heqja e anketës me nëpunësit civilë si burim i të dhënave, për shkak të problemeve të vazhdueshme në sigurimin e shkallëve adekuate të përgjigjes në administratat e rajonit.

### Raportimi i Monitorimit RAP

- Gjashtë raporte kombëtare të RAP Monitor, nga një për secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP) (36 gjithsej për tërë ciklin e RAP Monitor), me qëllim lehtësimin e publikimit në kohë dhe avokimit për rezultatet e monitorimit, në vend që të publikohen rezultatet e 18 muajve hulumtim në fund të procesit.
- Gjashtë raporte rajonale përmbledhëse për Ballkanin Perëndimor, nga një për secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP) (6 gjithsej).

## I.2 Pse dhe si WeBER Monitoron fushën “Menaxhimi i Financave Publike”

Mënyra se si planifikohen, ndahen, shpenzohen dhe raportohen burimet publike ka ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe integritetin e administratës publike. Prandaj, financat publike transparente, të përgjegjshme dhe të menaxhuara mirë pasqyrojnë përkushtimin e qeverisë për t’u shërbyer nevojave të qytetarëve dhe për t’i përdorur burimet me përgjegjësi. Fokusi i WeBER-it në formulimin pjesëmarrës të buxhetit dhe në transparencën e ekzekutimit të tij synon të vlerësojë se sa i hapur dhe llogaridhënës është në praktikë menaxhimi i financave publike. Monitorimi përfshin gjithashtu qasshmërinë dhe lehtësinë e përdorimit të dokumentacionit

buxhetor, pasi këto u mundësojnë qytetarëve dhe shoqërisë civile të marrin pjesë në mënyrë kuptimplote dhe të mbikëqyrin të gjithë ciklin buxhetor. Për më tepër, WeBER shqyrton nëse korniza ligjore dhe institucionale për prokurimin publik ofron bazë të qëndrueshme për zhvillimin e proceseve transparente dhe konkurruese, si dhe nëse në praktikë ekziston një sistem prokurimi publik transparent dhe konkurrues. Së fundi, një aspekt po aq i rëndësishëm i mbikëqyrjes së jashtme të financave publike vëzhgohet përmes transparencës së punës së institucioneve supreme të auditimit dhe praktikës së tyre për angazhim proaktiv të publikut. Dobësitë në transparencë, gjithëpërfshirje apo mekanizma të llogaridhënies rrezikojnë të nxisin joefikasitet dhe korrupsion, ndërsa sistemet e forta dhe të hapura të Menaxhimit të Financave Publike forcojnë besimin publik, përgjegjësinë fiskale dhe besueshmërinë e përgjithshme të reformës së administratës publike.

Monitorimi në fushën e Menaxhimit të Financave Publike bazohet në gjashtë Parime të SIGMA-s në këtë fushë:

**Parimi 23:** Buxheti vjetor është gjithëpërfshirës dhe hartohet brenda një kornize afatmesme të besueshme dhe të vazhdueshme, duke balancuar nevojat e politikave me kufizimet fiskale.

**Parimi 25:** Qeveria e zbaton buxhetin në përputhje me parashikimet dhe raporton për të në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, duke mundësuar shqyrtim në kohë.


**Parimi 26:** Organet e administratës publike menaxhojnë burimet në mënyrë efektive dhe në përputhje me rregullat, për të arritur objektivat e tyre.

**Parimi 28:** Legjislacioni për prokurimin publik, përfshirë partneritetet publiko-private dhe koncesionet, bazohet në parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës, si dhe mbështetet nga një kornizë e qëndrueshme qeverisëse.

**Parimi 29:** Autoritetet kontraktuese zhvillojnë procedurat e prokurimit publik, përfshirë partneritetet publiko-private, në mënyrë efikase dhe ekonomike.

**Parimi 31:** Të gjitha fondet publike auditohen në mënyrë efektive nga një auditor i pavarur, i cili ofron siguri për përdorimin e burimeve publike dhe ndihmon në përmirësimin e funksionimit të sektorit publik.

Këto Parime vlerësohen nga perspektiva e disponueshmërisë dhe qasshmërisë së të gjithë informacionit përkatës mbi procesin buxhetor, duke shqyrtuar njëkohësisht shkallën në të cilën në sistem ekzistojnë procese të hapura dhe konkurruese të prokurimit publik. Fokusi në transparencë dhe qasje të hapur synon të përcaktojë në çfarë mase autoritetet përkatëse publikojnë informacion që i ndihmon publikut të interesuar të fitojë njohuri mbi aspektet kyçe të sistemit – formulimin dhe ekzekutimin e buxhetit, si dhe auditimin e përdorimit të burimeve publike.



Periudha e monitorimit për Menaxhimin e Financave Publike përfshin zhvillimet që nga cikli i fundit i RAP Monitor, i cili zgjati nga janari deri në nëntor 2022. Prandaj, ky raport fokusohet kryesisht në vitet 2023 dhe 2024, si dhe në zhvillimet e fundit të vitit 2022 që nuk janë përfshirë në ciklin e mëparshëm. Megjithëse ky raport ofron një krahasim të gjetjeve me edicionet e mëparshme të RAP Monitor, pikët e vendeve nuk janë të krahasueshme me monitorimin e mëparshëm për shkak të ndryshimeve metodologjike.

**Sub- indikator** i parë fokusohet në ekzistencën e kornizave politike dhe ligjore që parashohin një proces gjithëpërfshirës dhe transparent të hartimit të buxhetit, si dhe përfshirjen e qytetarëve, duke shqyrtuar njëkohësisht nëse palët e jashtme të interesit angazhohen në praktikë. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë tri intervista me informatorë kyç nga akterë jo-shtetërorë, të cilët posedojnë ekspertizë të konsiderueshme në këtë fushë dhe/ose përvojë në pjesëmarrjen në proceset e analizuara, si dhe përdorin gjetjet nga anketa e perceptimit publik.

**Tabela 2.** Elementet e indikatorit në kuadër të sub -indikatorit 1

Elementi i Indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 1.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon si objektiv përmirësimin e gjithëpërfshirjes dhe transparencës së procesit të hartimit të buxhetit.	Strategjia dhe Politika
E 1.2 Rregulloret parashohin përfshirjen e qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit.	Legjislacioni
E 1.3 Palëve të jashtme të interesit u ofrohet paraprakisht informacion i plotë, duke u dhënë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për konsultimet në procesin e hartimit të buxhetit.	Praktika në zbatim
E 1.4 Organet përgjegjëse qeveritare janë proaktive në sigurimin e përfshirjes së një game të gjerë palësh të jashtme të interesit në procesin e hartimit të buxhetit.	Praktika në zbatim

E 1.5 Aktorët kyç jo-shtetërorë e konsiderojnë procesin e hartimit të buxhetit si gjithëpërfshirës dhe transparent.	Rezultati dhe ndikimi
E 1.6 Perceptimi i qytetarëve mbi gjithëpërfshirjen e procesit të hartimit të buxhetit	Rezultati dhe ndikimi

**Sub- indikator i dytë** vlerëson disponueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e dokumentacionit buxhetor, duke shqyrtuar njëkohësisht qashtëmërinë e raporteve. Monitorimi i elementeve të strategjisë, politikave dhe praktikës realizohet përmes analizës së dokumenteve strategjike dhe të dhënave zyrtare të publikuara në faqet e internetit të institucioneve përkatëse. Vlerësimi i rezultateve dhe ndikimit bazohet në gjetjet e marra nga tri intervista me informatorë kyç dhe nga anketa e perceptimit publik.

**Tabela 3.** Elementet e indikatorit në kuadër të sub-indikatorit 2

Elementi i indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 2.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon përmirësimin e transparencës së dokumentacionit buxhetor.	Strategjia dhe Politika
E 2.2 Buxheti vjetor i miratuar përfshin një perspektivë afatmesme që ilustron se si do të zhvillohen të hyrat dhe shpenzimet përtej vitit të ardhshëm fiskal.	Praktika në zbatim
E 2.3 Dokumentacioni buxhetor paraqet ndikimin e buxhetit në fushat prioritare të politikave.	Praktika në zbatim
E 2.4 Buxheti për Qytetarë publikohet rregullisht online.	Praktika në zbatim
E 2.5 Raportet brenda vitit për ekzekutimin e buxhetit publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online	Praktika në zbatim
E 2.6 Raportet gjysmëvjetore për ekzekutimin e buxhetit publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim
E 2.7 Raportet brenda vitit dhe gjysmëvjetore për ekzekutimin e buxhetit përmbajnë të dhëna mbi shpenzimet buxhetore sipas klasifikimeve të ndryshme të shpenzimeve	Praktika në zbatim
E 2.8 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim
E 2.9 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit përmbajnë të dhëna mbi shpenzimet buxhetore sipas klasifikimeve të ndryshme të shpenzimeve.	Praktika në zbatim
E 2.10 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit ose raportet e veçanta përmbajnë informacion mbi ndikimet e rëndësishme të zbatimit të buxhetit në fushat prioritare të politikave.	Praktika në zbatim
E 2.11 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit ose raportet e veçanta përmbajnë informacion mbi investimet kapitale	Praktika në zbatim
E 2.12 Raportet e konsoliduara vjetore mbi kontrollin e brendshëm financiar dhe auditimin e brendshëm publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online	Praktika në zbatim

E 2.13 Të dhënat buxhetore publikohen në format të hapur (open data).	Praktika në zbatim
E 2.14 Aktorët kyç jo-shtetërorë konsiderojnë se dokumentacioni buxhetor është gjithëpërfshirës dhe mundëson hulumtime të mëtejshme	Rezultati dhe ndikimi
E 2.15 Perceptimi i qytetarëve mbi disponueshmërinë e informacionit për ekzekutimin e buxhetit.	Rezultati dhe ndikimi

**Sub-indikatori i tretë** shqyrton qasjen e hapur dhe konkurrueshmërinë e sistemit të prokurimit publik. Konkretisht, vlerësimi analizon ekzistencën dhe disponueshmërinë publike të planeve dhe raporteve të prokurimit, nivelin e konkurrencës dhe qasjes së hapur të procedurave, si dhe karakteristikat miqësore për përdoruesit të portalit të prokurimit publik.

Monitorimi i strategjisë dhe politikave, legjislacionit dhe praktikës realizohet duke kombinuar burime të ndryshme të të dhënave për të maksimizuar besueshmërinë e rezultateve. Ai përfshin analizë cilësore të dokumenteve strategjike, akteve ligjore dhe të dhënave zyrtare që janë publikisht të qasshme ose të siguruara nga institucionet përgjegjëse përmes kërkesave për qasje në dokumente publike (FOI). Analiza e disa elementeve të tipit praktikë në kuadër të këtij sub-indikatorit kryhet mbi një mostër prej pesë autoriteteve kontraktuese me vlerat më të larta të kontraktuara të prokurimit në vitin kalendarik paraardhës të vitit të monitorimit. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë tri intervista me informatorë kyç.

**Tabela 4.** Elementet e indikatorit në kuadër të sub-indikatorit 3

Elementet e indikatorit: numri dhe titulli	Loji
E 3.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon përmirësimin e transparencës dhe konkurrueshmërisë së sistemit të prokurimit publik.	Strategjia dhe Politika
E 3.2 Rregulloret përcaktojnë transparencën dhe konkurrueshmërinë si parime kyçe të proceseve të prokurimit publik.	Legjislacion
E 3.3 Nuk ekziston legjislacion i veçantë që krijon përjashtime nga ligji i përgjithshëm për prokurimin publik.	Legjislacion
E 3.4 Ekziston një organ qendror i prokurimit i projektuar për të mbështetur transparencën dhe konkurrueshmërinë e proceseve të prokurimit publik.	Organizimi institucional
E 3.5 Organi qendror i prokurimit raporton rregullisht para publikut për zbatimin e përgjithshëm të politikës së prokurimit publik.	Praktika në zbatim
E 3.6 Raportimi mbi politikën e prokurimit publik nga organi qendror është i kuptueshëm dhe miqësor për qytetarët.	Praktika në zbatim
E 3.7 Organi qendror i shqyrtimit raporton rregullisht para publikut mbi procedurat për mbrojtjen e të drejtave të ofertuesve në prokurimin publik.	Praktika në zbatim

E 3.8 Portali i prokurimit publik është miqësor për përdoruesit.	Praktika në zbatim
E 3.9 Autoritetet kontraktuese në nivel qendror publikojnë rregullisht plane vjetore të përditësuara të prokurimit, të cilat janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim
E 3.10 Autoritetet kontraktuese në nivel qendror publikojnë rregullisht raporte vjetore të prokurimit, të cilat janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim
E 3.11 Procedurat e hapura përfaqësojnë metodën standarde të prokurimit publik.	Praktika në zbatim
E 3.12 Proceset e prokurimit publik janë konkurruese.	Praktika në zbatim
E 3.13 Të dhënat e prokurimit publik janë të disponueshme në format(e) të hapura.	Praktika në zbatim
E 3.14 Akterët kyç jo-shtetërorë e konsiderojnë sistemin e prokurimit publik si konkurrues dhe transparent.	Rezultati dhe impakti
E 3.15 Akterët kyç jo-shtetërorë konsiderojnë se përjashtimet nga ligji për prokurimin publik janë të rregulluara në mënyrë adekuate dhe zbatohen si duhet në praktikë.	Rezultati dhe impakti

**Sub-treguesi i katërt** fokusohet në komunikimin e rregullt dhe paraqitjen e kuptueshme për qytetarët të aktiviteteve dhe raporteve të Institucionit Suprem të Auditimit (ISA). Monitorimi i këtij sub-indikatorit bazohet në shqyrtimin e kornizës strategjike, rregulloreve dhe faqes zyrtare të ISA-s. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë intervista me informatorë kyç.

**Tabela 5.** Elementet e indikatorit në kuadër të sub- indikatorit 4

Elementet e indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 4.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të ISA-së me palët e jashtme të interesit.	Strategjia dhe Politika
E 4.2 Rregulloret përcaktojnë transparencën e punës së ISA-së.	Legjislacioni
E 4.3 Raportet vjetore të aktivitetit të ISA-së publikohen rregullisht dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim
E 4.4 Raportet e auditimit të ISA-së janë të kuptueshme për qytetarët dhe lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim
E 4.5 Të dhënat e përfshira në raportet e auditimit të jashtëm janë të disponueshme në format(e) të hapura.	Praktika në zbatim
E 4.6 ISA përdor një sërë kanalesh për komunikim të jashtëm dhe promovim të aktiviteteve dhe raporteve të saj.	Praktika në zbatim
E 4.7 Akterët kyç jo-shtetërorë e konsiderojnë punën e ISA-së si transparente dhe raportet e saj si lehtësisht të qasshme.	Rezultati dhe ndikimi

## II. Transparenca Dhe Qasja e Hapur e Menaxhimit Të Financave Publike

Ky seksion paraqet rezultatet e vlerësimit për Kosovën. Çdo nën-seksion paraqet rezultatet për një nën-indikator (gjithsej katër), duke filluar me një përmbledhje të shkurtër të zhvillimeve që nga PAR Monitor 2021/2022. Më pas vijon një vlerësim i detajuar i elementeve të nën-indikatorit, duke filluar nga korniza e politikave, legjislacionit dhe ajo institucionale, për të vazhduar me praktikën e zbatimit dhe për të përfunduar me rezultatet dhe ndikimin. Çdo vlerësim i nën-indikatorit përmbyllet me një grafik që paraqet pikët e dhëna.

Grafiku më poshtë paraqet rezultatet e përgjithshme për fushën e Menaxhimit të Financave Publike në Kosovë, të matura në një shkallë nga 0 deri në 100 pikë.

Transparenca dhe qasja e hapur e menaxhimit të financave publike  
(pikët 0-100)



## II.1 Gjithëpërfshirja dhe transparenca e procesit të hartimit të buxhetit

**Parimi 23:** Buxheti vjetor është gjithëpërfshirës dhe hartohet brenda një kornize afatmesme të besueshme dhe të vazhdueshme, duke balancuar nevojat e politikave me kufizimet fiskale

Pikët e dhëna për secilin element në sub-indikatorin 1: Gjithëpërfshirja dhe transparenca e procesit të hartimit të buxhetit.<sup>6</sup>

Elementet e indikatorit	Tipi i Elementit	Pikët
E 1.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon si objektiv përmirësimin e gjithëpërfshirjes dhe transparencës së procesit të hartimit të buxhetit.	Strategji dhe Politika	0/1
E 1.2 Rregulloret parashohin përfshirjen e qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit.	Legjislacioni	1/1
E 1.3 Palëve të jashtme të interesit u ofrohet paraprakisht informacion i plotë, duke u dhënë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për konsultimet në procesin e hartimit të buxhetit.	Praktika në zbatim	0/2
E 1.4 Organet përgjegjëse qeveritare janë proaktive në sigurimin e përfshirjes së një game të gjerë palësh të jashtme të interesit në procesin e hartimit të buxhetit.	Praktika në zbatim	0/3.5
E 1.5 Akterët kyç jo-shtetërorë e konsiderojnë procesin e hartimit të buxhetit si gjithëpërfshirës dhe transparent.	Rezultati dhe ndikimi	0/3
E 1.6 Perceptimi i qytetarëve mbi gjithëpërfshirjen e procesit të hartimit të buxhetit.	Rezultati dhe ndikimi	0.5/2
<b>Pikët totale për sub-indikatorin 1</b>		<b>1.5/12.5</b>

<sup>6</sup> Sub-indikatorin i parë fokusohet në nën-parimin vijues të SIGMA-s: Qeveria nxit angazhimin e qytetarëve në procesin buxhetor duke vënë në dispozicion publik një paketë të plotë dokumentacioni buxhetor, duke përgatitur buxhetin për qytetarë dhe duke përdorur mjete të buxhetimit të hapur.

---

Ky sub-indikator analizon qasjen e hapur dhe gjithëpërfshirjen e procesit të hartimit të buxhetit, duke përfshirë ekzistencën e qasjeve strategjike për transparencë dhe përfshirje, rregullat që parashohin pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe sigurimin që akterët e jashtëm të marrin informacion të plotë dhe në kohë për konsultime. Ai shqyrton gjithashtu rolin proaktiv të institucioneve përgjegjëse në përfshirjen e një game të gjerë akterësh jo-shtetërorë, si dhe perceptimin e akterëve kyç dhe qytetarëve lidhur me nivelin e transparencës dhe përfshirjes në këtë fazë të procesit buxhetor. Sipas Raportit të SIGMA-s 2024 për Administratën Publike në Kosovë, vlerësimi i performancës në menaxhimin e financave publike – përfshirë aspektet e transparencës – është pjesë e analizës së treguesve të qeverisjes së mirë dhe kërkon përmirësime të mëtejshme, pasi praktikat e komunikimit dhe angazhimit publik mbeten sfiduese në kontekstin e standardeve moderne të administratës publike.

---

## Si qëndron Kosova në aspektin regional?

**Sub-indicatori 1:** Gjithëpërfshirja dhe transparenca e procesit të formimit të buxhetit (pikët maksimale 12.5)

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2022–2026 parasheh masa për përmirësimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes vetëm në lidhje me raportimin buxhetor dhe mbikëqyrjen e buxhetit, konkretisht në kuadër të Objektivit Specifik 4.2, por jo gjatë fazës së zhvillimit dhe hartimit të buxhetit. Aktivitetet e planifikuara nën këtë objektiv fokusohen në përmirësimin e transparencës, pa masa konkrete për përfshirjen e publikut më të gjerë në procesin e hartimit të buxhetit. Si rezultat, kriteret për përmirësimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në hartimin e buxhetit, me përcaktim të qartë të përgjegjësi, nuk përmbushen dhe nuk janë dhënë pikë.

Sa i përket kornizës ligjore, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë,<sup>7</sup> si dhe ndryshimet e tij, nuk përmbajnë dispozita specifike për pjesëmarrjen e qytetarëve. Megjithatë, Rregullorja e Punës e Qeverisë së Republikës së Kosovës<sup>8</sup> parashikon konsultim publik për të gjitha iniciativat ligjore, përfshirë Projektligjin për Ndarjet Buxhetore, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kapitullin IV dhe nenin 46. Përrjashtim bëjnë vetëm projektligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, siç përcaktohet në nenin 31. Duke qenë se nuk ka kufizime të tjera specifike lidhur me pjesët e projektligjit që mund të komentohen, konkludohet se i gjithë buxheti është i hapur për konsultim publik. Në bazë të kësaj, kriteri për konsultimin e qytetarëve mbi buxhetin në tërësi konsiderohet i përmbushur dhe është dhënë një pikë.


Pjesëmarrja publike në proceset e konsultimit në nivel qendror është e kufizuar dhe, në praktikë, pothuajse mungon. Në kuadër të këtij treguesi janë zhvilluar

---

<sup>7</sup> Ligji në Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënie, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524&langid=2>.

<sup>8</sup> Rregullorja e Punës e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i disponueshëm në: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022\\_08\\_09\\_RulesofProcedureoftheAssemblyoftheRepublicofKosovo\\_mCJNJBy62.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022_08_09_RulesofProcedureoftheAssemblyoftheRepublicofKosovo_mCJNJBy62.pdf).

intervista me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile<sup>9</sup>, të cilët theksuan se nuk ka pajtim që procesi i hartimit të buxhetit është transparent apo gjithëpërfshirës. Në nivel qendror, gjatë përgatitjes së buxhetit nuk mbahen dëgjime publike apo konsultime me palë të treta, dhe informacioni apo materialet nuk ndahen në mënyrë të plotë ose me kohë me palët e interesuara. Edhe pse disa konsultime zhvillohen në nivel komunal, ky tregues fokusohet vetëm në institucionet e nivelit qendror. Nuk ka hapësirë për komente nga grupet e interesit, përfshirë asociacionet e bizneseve, sindikatat, organizatat profesionale, akademinë, organizatat për barazi gjinore apo grupet e marginalizuara, dhe komentet e tyre nuk reflektohen në procesin buxhetor. Në përgjithësi, vlerësimi tregon se procesi i hartimit të buxhetit në nivel qendror nuk është i hapur për aktorët e jashtëm dhe nuk ofron transparencë apo gjithëpërfshirje të mjaftueshme.



9 Gjatë Shtatorit dhe Tetorit, tre intervista për këtë indikator janë zhvilluar. Intervistat janë mbajtur me dy përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe një ekspert i fushës.

## II.2 Disponueshmëria dhe gjithëpërfshirja e dokumentimit buxhetor

**Parimi 23:** Buxheti vjetor është gjithëpërfshirës dhe hartohet brenda një kornize afatmesme të besueshme dhe të vazhdueshme, duke balancuar nevojat e politikave me kufizimet fiskale.

**Parimi 25:** Qeveria e zbaton buxhetin në përputhje me parashikimet dhe raportin për të në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, duke mundësuar shqyrtim në kohë.

**Parimi 26:** Organet e administratës publike menaxhojnë burimet në mënyrë efektive dhe në përputhje me rregullat, për të arritur objektivat e tyre.

Pikët e dhëna për secilin element në nën-indikatorin 2: Disponueshmëria dhe gjithëpërfshirja e dokumentacionit buxhetor.<sup>10</sup>

Elementet e indikatorit	Tipi i elementit	Pikët
E 2.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon përmirësimin e transparencës së dokumentacionit buxhetor.	Strategji dhe politika	1/1
E 2.2 Buxheti vjetor i miratuar përfshin një perspektivë afatmesme që ilustron se si do të zhvillohen të hyrat dhe shpenzimet përtej vitit të ardhshëm fiskal.	Praktika në zbatim	3/3
E 2.3 Dokumentacioni buxhetor paraqet ndikimin e buxhetit në fushat prioritare të politikave.	Praktika në zbatim	0/2
E 2.4 Buxheti për Qytetarë publikohet rregullisht online.	Praktika në zbatim	2/2

<sup>10</sup> Sub-indikatorin i dytë fokusohet në nën-parimet vijuese të SIGMA-s: Qeveria nxit angazhimin e qytetarëve në procesin buxhetor duke vënë në dispozicion publik një set të plotë të dokumentacionit buxhetor, duke përgatitur Buxhetin për Qytetarë dhe duke përdorur mjete të buxhetimit të hapur; Dokumentacioni vjetor i buxhetit është gjithëpërfshirës dhe përfshin të gjitha shpenzimet dhe të hyrat publike, rreziqet fiskale, shpenzimet tatimore dhe angazhimet shumëvjeçare; Buxheti paraqitet sipas klasifikimit administrativ, ekonomik, funksional dhe programor, si dhe përdor informacion jo-financiar për performancën. Shpenzimet që lidhen me politika si tranzicioni i gjelbër dhe barazia gjinore monitorohen për të vlerësuar ndikimin e iniciativave kur ekzistojnë objektiva apo synime përkatëse; Ministria e Financave monitoron ekzekutimin e buxhetit gjatë gjithë vitit financiar dhe publikon rregullisht informacione mbi ekzekutimin e buxhetit për të mundësuar vendimmarrje efektive dhe transparencë; Qeveria publikon raportin e saj financiar vjetor jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të vitit financiar. Institucioni Suprem i Auditimit e auditoron këtë raport, ndërsa Kuvendi e shqyrton atë përpara debatit për buxhetin e ardhshëm; Raporti financiar vjetor i qeverisë është gjithëpërfshirës dhe i bazuar në një kornizë të përshtatshme raportimi financiar, është në një format që pasqyron formatin e buxhetit, shpjegon devijimet nga shifrat buxhetore, përfshin analizë të asetëve dhe detyrimeve të shtetit, si dhe përmban informacion jo-financiar mbi performancën duke krahasuar rezultatet me objektivat e vendosura; Qeveria, në raportin financiar vjetor ose në një raport të veçantë, ofron informacion mbi ndikimet e rëndësishme ekonomike, sociale dhe mjedisore të politikave, prokurimeve dhe operacioneve të saj; Qeveria ofron informacion mbi investimet kapitale në raportin financiar vjetor ose në një raport të veçantë; Një ministri e vetme koordinon zbatimin e kontrollit të brendshëm, shqyrton progresin dhe raporton çdo vit para qeverisë për zhvillimin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik.

E 2.5 Raportet brenda vitit për ekzekutimin e buxhetit publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim	1.5/3
E 2.6 Raportet gjysmëvjetore për ekzekutimin e buxhetit publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim	3/3
E 2.7 Raportet brenda vitit dhe gjysmëvjetore për ekzekutimin e buxhetit përmbajnë të dhëna mbi shpenzimet buxhetore sipas klasifikimeve të ndryshme të shpenzimeve.	Praktika në zbatim	2/3
E 2.8 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim	3/3
E 2.9 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit përmbajnë të dhëna mbi shpenzimet buxhetore sipas klasifikimeve të ndryshme të shpenzimeve.	Praktika në zbatim	2/4
E 2.10 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit ose raportet e veçanta përmbajnë informacion mbi ndikimet e rëndësishme të zbatimit të buxhetit në fushat prioritare të politikave.	Praktika në zbatim	0/2
E 2.11 Raportet vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit ose raportet e veçanta përmbajnë informacion mbi investimet kapitale.	Praktika në zbatim	0/3
E 2.12 Raportet e konsoliduara vjetore mbi kontrollin e brendshëm financiar dhe auditimin e brendshëm publikohen me kohë dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim	0/2
E 2.13 Të dhënat buxhetore publikohen në format të hapur	Praktika në zbatim	0/2
E 2.14 Akterët kyç jo-shtetërorë konsiderojnë se dokumentacioni buxhetor është gjithëpërfshirës dhe mundëson hulumtime të mëtejshme.	Rezultati dhe ndikimi	0/3
E 2.15 Perceptimi i qytetarëve mbi disponueshmërinë e informacionit për ekzekutimin e buxhetit.	Rezultati dhe ndikimi	1/2
<b>Pikët totale të sub- indikatorit 2</b>		<b>18.5/38</b>

---

Sub-indikator 2 vlerëson disponueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e dokumentacionit buxhetor në Kosovë. Vlerësimi bazohet në analizën e ekzistencës së një dokumenti strategjik në fuqi që parashikon përmirësimin e transparencës së dokumentacionit buxhetor, si dhe në shqyrtimin e dokumenteve kryesore buxhetore të publikuara gjatë ciklit buxhetor. Në kuadër të këtij nën-treguesi vlerësohet nëse buxheti vjetor i miratuar përfshin një perspektivë afatmesme mbi zhvillimin e të hyrave dhe shpenzimeve përtej vitit të ardhshëm fiskal, nëse dokumentacioni buxhetor paraqet ndikimet e buxhetit në fushat prioritare të politikave, si dhe nëse Buxheti për Qytetarë publikohet rregullisht.

Gjithashtu, vlerësohet publikimi me kohë dhe qasshmëria online e raporteve brenda vitit për ekzekutimin e buxhetit, raporteve gjysmëvjetore dhe raporteve vjetore përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit, përfshirë përmbajtjen e tyre sipas klasifikimeve të shpenzimeve, informacionin mbi investimet kapitale dhe ndikimet kryesore të zbatimit të buxhetit në fushat prioritare të politikave. Përveç kësaj, vlerësimi përfshin publikimin e raporteve të konsoliduara vjetore mbi kontrollin e brendshëm financiar dhe auditimin e brendshëm, publikimin e të dhënave buxhetore në format të hapur (open data), si dhe perceptimin e aktorëve jo-shtetërorë dhe qytetarëve lidhur me disponueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit për ekzekutimin e buxhetit.

---

Kosova ka një angazhim të qartë politik për përmirësimin e transparencës buxhetore përmes Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2022–2026. Nën Objektivin Specifik 4.2, strategjia përcakton masa konkrete, përfshirë raportimin tremujor dhe mujor mbi performancën financiare dhe jofinanciare, zbatimin e investimeve kapitale dhe ekzekutimin e buxhetit në nivel qendror dhe lokal. Përgjegjësitë janë të përcaktuara qartë për Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Thesarin, ndërsa parashihet edhe mbështetje nga donatorët. Për më tepër, Ligjet për Ndarjet Buxhetore për vitet 2024 dhe 2025 përfshijnë perspektiva fiskale afatmesme dhe supozime të ndara sipas kategorive, programeve dhe shfrytëzuesve buxhetorë, çka në aspekt formal i përmbush kërkesat kyçe të treguesit.<sup>11</sup>

Ndërkohë, ligjet e buxhetit nuk publikojnë dokumente të veçanta analitike që arsyetojnë zgjedhjet buxhetore ose vlerësojnë ndikimin e tyre, siç kërkohet nga metodologjia e vlerësimit. Informatat për Qytetarë publikohet çdo vit për buxhetin përkatës në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, me qëllim që elementet kryesore të buxhetit të komunikohen në mënyrë të thjeshtuar për publikun e gjerë.<sup>12</sup> Raportet për ekzekutimin e buxhetit në përgjithësi publikohen rregullisht dhe janë të qasshme përmes faqes së Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave, por ka vonesa të dukshme, si në rastin e raportit gjysmëvjetor për vitin 2025, i cili është publikuar me vonesë dhe për këtë arsye është vlerësuar negativisht.<sup>13</sup> Raportet e vëzhguara gjysmëvjetore për vitet 2024 dhe 2025 janë publikuar dhe janë lehtësisht të qasshme.<sup>14</sup> Përveç kësaj,

---

11 Artikulli 4, Tabela 3.1, Ligji në alokimin e buxhetit (Ligji i Buxhetit 2024) për 2024, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85052>; dhe tabela 1 dhe 4.1, Ligji në alokimin e buxhetit për 2025 (Ligji i Buxhetit 2025), i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>.

12 Informimi për qytetarë për dy vitet e fundit është i disponueshëm në: <https://mfpt.rks-gov.net/Buxheti/Page/329>.

13 Seria mujore fiskale, e disponueshme në: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>.

14 Raporti gjysmë- vjetor, i disponueshëm në <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/33>.

janë të disponueshme edhe raportet nëntëmujore.<sup>15</sup>

Raporti Gjysmëvjetor 2025 i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i plotëson kërkesat sa i përket klasifikimit ekonomik dhe atij administrativ/organizativ, por nuk përfshin klasifikimin funksional.<sup>16</sup> Raporti më i fundit financiar vjetor është shqyrtuar dhe klasifikimi administrativ paraqitet plotësisht përmes Aneksit nr. 3, i cili detajon shpenzimet për të gjitha organizatat buxhetore qendrore dhe lokale për vitin 2024.<sup>17</sup> Klasifikimi ekonomik gjithashtu është i përfshirë qartë, duke ndjekur kornizën e Statistikave të Financave Qeveritare të FMN-së (IMF GFS), me kategori të detajuara të shpenzimeve të paraqitura në pasqyrat kryesore financiare dhe shënimet shpjeguese. Megjithatë, klasifikimi funksional nuk paraqitet publikisht. Edhe pse raporti i referohet sistemit IMF GFS, ai nuk përfshin tabela të shpenzimeve sipas fushave funksionale, si arsimi apo shëndetësia. Klasifikimi sipas programeve mbulohet vetëm pjesërisht, i kufizuar në masa specifike (p.sh. menaxhimi i pandemisë, rimëkëmbja ekonomike dhe plani emergjent energjetik i BE-së), dhe jo në një ndarje të plotë dhe gjithëpërfshirëse sipas programeve.

Raportet e brendshme nuk janë të disponueshme publikisht dhe nuk ekziston një kërkesë ligjore për publikimin e tyre, gjë që ka çuar në një vlerësim negativ të këtij elementi. Kufizime të mëtejshme në transparencë vërehen edhe në portalin e të dhënave të hapura, i cili aktualisht nuk është funksional dhe ka qenë i tillë për një kohë të gjatë, duke e bërë të pamundur qasjen në të dhënat buxhetore dhe duke mos i paraqitur ato në formatet e kërkuara nga treguesi. Megjithëse është i disponueshëm dhe përditësohet rregullisht një set i plotë mujor fiskal (2006–2025) në format Excel, që mbulon të hyrat dhe shpenzimet në nivel qendror dhe lokal,<sup>18</sup> kjo e vetme nuk është e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e treguesit apo për të arsyetuar një vlerësim pozitiv.

Janë intervistuar tre akterë kyç jo-shtetërorë, me përvojë në hartimin e dokumentacionit buxhetor. Ata nuk janë pajtuar për asnjërën nga çështjet e vlerësuara, prandaj është dhënë vlerësim negativ. Vetëm dy nga të intervistuarit priren të pajtohen se buxhetet vjetore të disponueshme janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse. Buxhetet vjetore nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm për qëllime hulumtimi dhe hartimi politikash. Të intervistuarit konsiderojnë se raportet e ekzekutimit të buxhetit nuk janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse dhe se nuk ofrojnë informacion adekuat për qëllime hulumtimi.

15 Raporti nëntë mujor, i disponueshëm në <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/33>.


16 Raporti gjysmë vjetor 2025, I disponueshëm në [file:///C:/Users/User/Downloads/Raporti%20N%C3%ABnt%C3%ABmujor%20Financiar%202025%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Raporti%20N%C3%ABnt%C3%ABmujor%20Financiar%202025%20(1).pdf).

17 Raporti financiar nëntë-mujor 2025, i disponueshëm në <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/33>.

18 Seria fiskale mujore, i disponueshëm në <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>.

## Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

**Sub-indicatori 2:** Disponueshmeria dhe gjithëpërfshirja e dokumentacionit buxhetor (pikët maksimale 38)



### II.3 Transparenca dhe konkurrueshmëria në sistemin e prokurimit publik

**Parimi 28:** Legjislacioni për prokurimin publik, përfshirë partneritetet publiko-private dhe koncesionet, bazohet në parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrueshmërisë, dhe mbështetet nga një kornizë e qëndrueshme qeverisëse.

**Parimi 29:** Autoritetet kontraktuese zhvillojnë procedurat e prokurimit publik, përfshirë partneritetet publiko-private, në mënyrë efektive dhe ekonomike.

Pikët e dhëna për secilin element në sub-indikatorin 3: Transparenca dhe konkurrueshmëria e sistemit të prokurimit publik.<sup>19</sup>

<sup>19</sup> Sub-indikatorin e tretë fokusohet në nën-parimet vijuese të SIGMA-s: Administrata publike ka politika të qarta dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin afatgjatë të sistemit të prokurimit publik, përfshirë partneritetet publiko-private (PPP) dhe koncesionet; Legjislacioni për prokurimin publik, përfshirë PPP-të dhe koncesionet, pasqyron parime të njohura ndërkombëtare, si vlera për para (value for money), konkurrenca e lirë, transparenca, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, njohja reciproke dhe proporcionaliteti; Një organ me mandat të qartë politik dhe ligjor në nivel qendror është i ngarkuar me funksionin e hartimit të politikave për të drejtuar dhe menaxhuar reformën e prokurimit publik. Funksionet dhe përgjegjësitë kyçe për zbatimin e sistemit të prokurimit publik janë të shpërndara qartë ndërmjet institucioneve qendrore të prokurimit, të cilat kanë autoritetin dhe burimet e nevojshme; Një organ qendror i prokurimit monitoron, mbikëqyr dhe vlerëson sistemin e prokurimit dhe identifikon përmirësime të mundshme. Ai siguron qasje publike në të dhëna të konsoliduara mbi operacionet e prokurimit publik (përfshirë dhënien dhe zbatimin e kontratave); Autoritetet kontraktuese përdorin gjerësisht prokurimin elektronik (e-prokurimin), i cili mbulon të gjitha fazat e procesit të prokurimit; Tregu i prokurimit publik është konkurrues dhe tërheq interesin e operatorëve ekonomikë vendorë dhe ndërkombëtarë, veçanërisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; Autoritetet kontraktuese hartojnë plane vjetore ose shumëvjeçare të prokurimit, të harmonizuara me planifikimin buxhetor, dhe i publikojnë ato me kohë. Një analizë e thelluar e nevojave dhe hulumtimi i tregut udhëheqin përgatitjen e secilit prokurim, përfshirë përcaktimin e rezultateve të dëshiruara; Procedurat konkurruese janë metoda standarde e prokurimit, ndërsa autoritetet kontraktuese përdorin procedura të tjera vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara siç duhet.

Elementet e indikatorit	Tipi i elementit	Pikët
E 3.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon përmirësimin e transparencës dhe konkurrueshmërisë së sistemit të prokurimit publik.	Strategji dhe politika	0.5/1
E 3.2 Rregulloret përcaktojnë transparencën dhe konkurrueshmërinë si parimet kyçe të proceseve të prokurimit publik.	Legjislacioni	1/1
E 3.3 Nuk ekziston legjislacioni i veçantë që krijon përjashtime nga ligji i përgjithshëm për prokurimin publik.	Legjislacioni	0/1.5
E 3.4 Ekziston një organ qendror i prokurimit i projektuar për të mbështetur transparencën dhe konkurrueshmërinë e proceseve të prokurimit publik	Vendosje institucionale	2/2
E 3.5 Organi qendror i prokurimit raporton rregullisht para publikut për zbatimin e përgjithshëm të politikës së prokurimit publik.	Praktika në zbatim	2/2
E 3.6 Raportimi mbi politikën e prokurimit publik nga organi qendror është i kuptueshëm dhe miqësor për qytetarët.	Praktika në zbatim	1.5/1.5
E 3.7 Organi qendror i shqyrtimit raporton rregullisht para publikut mbi procedurat për mbrojtjen e të drejtave të ofertuesve në prokurimin publik.	Praktika në zbatim	2.5/2.5
E 3.8 Portali i prokurimit publik është miqësor për përdoruesit.	Praktika në zbatim	2.5/3
E 3.9 Autoritetet kontraktuese në nivel qendror publikojnë rregullisht plane vjetore të përditësuara të prokurimit, të cilat janë lehtësisht të qasshme online	Praktika në zbatim	3/3
E 3.10 Autoritetet kontraktuese në nivel qendror publikojnë rregullisht raporte vjetore të prokurimit, të cilat janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim	0/3
E 3.11 Procedurat e hapura përfaqësojnë metodën standarde të prokurimit publik.	Praktika në zbatim	0/2
E 3.12 Proceset e prokurimit publik janë konkurruese.	Praktika në zbatim	0/2
E 3.13 Të dhënat e prokurimit publik janë të disponueshme në format(e) të hapura.	Praktika në zbatim	1/2
E 3.14 Akterët kyç jo-shtetërorë e konsiderojnë sistemin e prokurimit publik si konkurrues dhe transparent.	Rezultati dhe ndikimi	1.5/3

E 3.15 Akterët kyç jo-shtetërorë konsiderojnë se përjashtimet nga ligji për prokurimin publik janë të rregulluara në mënyrë adekuate dhe zbatohen si duhet në praktikë.	Rezultati dhe ndikimi	0/3
<b>Pikët totale për sub-indikatorin 3</b>		<b>17.5/32.5</b>

Sub-indikatorin 3 shqyrton konkurrueshmërinë dhe transparencën e sistemit të prokurimit publik. Nga perspektiva strategjike dhe legjislative, vlerësohet nëse korniza e prokurimit publik parashikon përmirësime dhe nëse transparencja dhe konkurrueshmëria mbahen si parime kyçe. Në praktikë, analiza shqyrton nëse ekziston një organ qendror i prokurimit, nëse ai publikon rregullisht raporte dhe plane të prokurimit, si dhe sa të qarta dhe miqësore për përdoruesit janë këto dokumente. Po ashtu, vlerësohet përdorshmëria e portalit online të prokurimit. Përveç kësaj, rishikimi analizon procedurat e prokurimit për të përcaktuar nëse procedurat e hapura janë qasja standarde, nëse proceset janë konkurruese dhe nëse të dhënat e prokurimit janë publikisht të disponueshme në formate të hapura.

Kosova aktualisht nuk ka një strategji për prokurimin publik, dhe as Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike<sup>20</sup> dhe as Strategjia për Reformën e Administratës Publike nuk përfshijnë masa konkrete që synojnë posaçërisht transparencën në prokurim. Megjithatë Ministria e Financave Publike pranon dobësi sistematike, si dominimi i kriterit të çmimit më të ulët dhe transpozimi jo i plotë i direktivave të BE-së, si dhe planifikon miratimin e një Ligji të ri për Prokurimin Publik, ajo nuk parasheh veprime të qarta për përmirësimin e transparencës në praktikë.<sup>21</sup>

Ministria e Financave Publike synon të rrisë përdorimin e kriterit të Tenderit Ekonomikisht më të Favorshëm në vend të kriterit të çmimit më të ulët për dhënien e kontratave.<sup>22</sup> Kjo kontribuon në rregullimin dhe forcimin e konkurrueshmërisë në prokurimin publik.

Ligji për Prokurimin Publik e përcakton transparencën dhe konkurrencën si parime themelore dhe ndalon praktikën diskriminuese apo antikonkurruese.<sup>23</sup> Ai gjithashtu kërkon pjesëmarrje të gjerë, publikim të rregullt dhe specifikime teknike të qarta.<sup>24</sup> Megjithatë, LPP nuk është i vetmi akt që rregullon këtë fushë. Ligji për Partneritetet Publiko-Private (2011) në mënyrë të pjesshme devijon nga korniza e përgjithshme e prokurimit publik. Rregullat e prokurimit publik

20 Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike, 2022-2026. I disponueshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Public-Finance-Management-Strategy-of-Re-public-of-Kosovo-2022-2026.pdf>.

21 Ibid, faqe 30-31.

22 Plani i Veprimit të Menaxhimit të Financave Publike, aktivitetet 3.1.1, 3.1.6, dhe 3.1.7, i disponueshëm në <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Plani-i-Veprimit-an-qlisht.pdf>.

23 Ligji i Prokurimit Publik, Artikulli 1 dhe artikulli 7, paragrafi 2, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

24 Ligji në Prokurimin Publik, Artikulli 7 paragrafi 6, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

zbatohen vetëm në raste të caktuara ose kur ligji për PPP nuk e rregullon një çështje procedurale. Aty ku Ligji për Partneritetet Publiko-Private përmban dispozita specifike, ai ka përparësi ndaj Ligjit për Prokurimin Publik, i cili zbatohet vetëm në mënyrë subsidiare.<sup>25</sup> Ligji për Bankën Qendrore (2010) gjithashtu devijon shprehimisht nga Ligji për Prokurimin Publik. Në rast konflikti, ligji për Bankën Qendrore ka përparësi, dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK) përjashtohet nga zbatimi i Ligjit për Prokurimin Publik dhe disa ligjeve të tjera të përgjithshme. Si rrjedhojë, BQK operon sipas rregullave të veta të prokurimit dhe financave, dhe jo sipas kornizës së përgjithshme të prokurimit publik në Kosovë.<sup>26</sup>

Organet kryesore të prokurimit janë agjencia e pavarur rregullatore, Komisioni i Rregullatorit të Prokurimit Publik (KRPP), Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP). KRPP rregullohet nga Ligji për Prokurimin Publik, në Pjesën VI, ku përcaktohen funksionet e saj, kompetencat mbikëqyrëse, emërimi, shkarkimi dhe pezullimi i anëtarëve, organizimi dhe votimi, masat zbatuese dhe çështje të tjera, si dhe nga Rregullorja e Punës e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. CPA rregullohet nga Ligji për Prokurimin Publik, në Pjesën VII.<sup>27</sup>

PPRC ofron manuale, udhëzues video, pyetje të shpeshta (FAQ) dhe qasje në platformën e e-prokurimit.<sup>28</sup> Manualët përfshijnë dokumente në format PDF me informacione për Operatorët Ekonomikë, si regjistrimi i OE-ve në platformë,<sup>29</sup> manual përdorimi që përmban udhëzime për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, menaxhimin e ofertave dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit.

Për Autoritetet Kontraktuese (AK), përfshihen informacione mbi regjistrimin në platformë; përgatitjen dhe publikimin e tenderëve; udhëzues për përdorimin e kriterit të dhënies së kontratës “Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm” (MEAT); manual për menaxhimin e kontratave publike; si dhe manual për specifikimet teknike për furnizime dhe shërbime të zakonshme.

Autoritetet kontraktuese nuk publikojnë raporte të prokurimit në faqet e tyre zyrtare, por raportojnë vetëm pranë PPRC-së. Janë shqyrtuar dy raportet e fundit vjetore, për vitet 2023 dhe 2024, të cilat janë publikisht të disponueshme dhe të strukturuar mirë.<sup>30</sup>

---

25 Ligji në Partneritetin Publiko-Privat, Artikulli 7, paragrafi 3, Artikulli 8, paragrafi 2, dhe Artikulli 45, I disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2784>.

26 Ligji në Bankën Qendrore, Artikulli 73, paragrafi 1 dhe 2, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2696>.

27 Ligji në Prokurimin Publik, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

28 Liku i portalit E-prokurimi, I disponueshëm në <https://krpp.rks-gov.net/njoftimet>.

29 Video për Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik, i disponueshëm në <https://krpp.rks-gov.net/videmanualeta?language=EN>; dhe video manual për menaxhimin e kontratave, I disponueshëm në <https://krpp.rks-gov.net/menaxhimikontratesv?language=EN>.

30 Lista e raporteve vjetore të disponueshme të PPRC-së në e-prokurimi, i disponueshëm në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx>; PPRC Raporti Vjetor 2024, i disponueshëm në [https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti\\_Vjetor\\_KRPP\\_2024\\_ALB\\_431d89dd59.pdf](https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti_Vjetor_KRPP_2024_ALB_431d89dd59.pdf); dhe PPRC Raporti Vjetor 2023, i disponueshëm në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20Vjetor%202023.pdf>.


Në praktikë, dokumentacioni i plotë i tenderëve mund të aksesohet falas në portalin e e-Prokurimit dhe të shkarkohet në format të lexueshëm në Excel, përmes rezultateve të kërkimit të avancuar. Janë shqyrtuar planet vjetore të prokurimit të pesë institucioneve me planet me vlerën më të lartë të prokurimit. Përmes kërkesave për qasje në dokumente publike (FOI) është konfirmuar se planet e përditësuara janë të disponueshme në portalin e e-Prokurimit, prandaj ky element (3.9) është vlerësuar me pikët maksimale për publikimin dhe qasshmërinë e lehtë të planeve vjetore të prokurimit.

Ne kemi krahasuar të dhënat e disponueshme në portalin e e-Prokurimit për vitin e fundit kalendarik. Në vitin 2024<sup>31</sup> janë zhvilluar gjithsej 10,012 procedura prokurimi, por numri i procedurave sipas llojit nuk paraqitet, prandaj nuk është e mundur të konfirmohet numri i procedurave të hapura. Nga të dhënat e disponueshme rezulton se 92% e vlerës totale të kontraktuar vjen nga procedurat e hapura, duke mos e tejkaluar pragun minimal të kërkuar prej 95% për këtë element.<sup>32</sup>

Nga intervistat e zhvilluara me akterët kyç jo-shtetërorë, të tre priren të pajtohen se prokurimi publik është transparent, ndërsa jo të gjithë pajtohen se ai është konkurrues. Të pyetur nëse ligji për prokurimin publik i rregullon në mënyrë adekuate përjashtimet nga zbatimi i tij dhe nëse përjashtimet në praktikë janë të kufizuara, njëri nga të intervistuarit nuk është pajtuar plotësisht me të dyja pyetjet.

### Si qëndron Kosova në aspektin regional?

**Sub-indikatori 3:** Transparenca dhe konkurrueshmera e sistemit të prokurimit publik (pikët maksimale 32.5)



31 PPRC Raporti Vjetor 2024, faqe 104, i disponueshëm në: [https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti\\_Vjetor\\_KRPP\\_2024\\_ALB\\_431d89dd59.pdf](https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti_Vjetor_KRPP_2024_ALB_431d89dd59.pdf).

32 PPRC Raporti Vjetor 2024, faqe 113, i disponueshëm në: [https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti\\_Vjetor\\_KRPP\\_2024\\_ALB\\_431d89dd59.pdf](https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti_Vjetor_KRPP_2024_ALB_431d89dd59.pdf).

## II.4 Qasja e hapur dhe transparenca e punës së institucionit shtetëror të auditimit

**Parimi 31:** Të gjitha fondet publike auditohen në mënyrë efektive nga një auditor i pavarur, i cili siguron garanci për përdorimin e burimeve publike dhe ndihmon në përmirësimin e funksionimit të sektorit publik.

Pikët e dhëna për secilin element në sub-indikatorin 4: Qasja e hapur dhe transparenca e punës së institucionit shtetëror të auditimit.<sup>33</sup>

Elementet e indikatorit	Tipi i elementit	Pikët
E 4.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parashikon përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të Institucionit Suprem të Auditimit (ISA) me palët e jashtme të interesit.	Strategjia dhe Politika	1/1
E 4.2 Rregulloret përcaktojnë transparencën e punës së ISA-së.	Legjislacioni	1/1
E 4.3 Raportet vjetore të aktivitetit të ISA-së publikohen rregullisht dhe janë lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim	4/4
E 4.4 Raportet e auditimit të ISA-së janë të kuptueshme për qytetarët dhe lehtësisht të qasshme online.	Praktika në zbatim	4/4
E 4.5 Të dhënat e përfshira në raportet e auditimit të jashtëm janë të disponueshme në format të hapura	Praktika në zbatim	0/2
E 4.6 ISA përdor një sërë kanalesh për komunikim të jashtëm dhe promovim të aktiviteteve dhe raporteve të saj.	Praktika në zbatim	2/2
E 4.7 Akterët kyç jo-shtetërorë e konsiderojnë punën e ISA-së si transparente dhe raportet e saj si lehtësisht të qasshme.	Rezultati dhe ndikimi	3/3
<b>Pikët totale për sub-indikatorin 4</b>		<b>15/17</b>

<sup>33</sup> Sub-indikatorin i katërt fokusohet në nën-parimet vijuese të SIGMA-s: Raportet e auditimit janë koncize dhe përmbajnë rekomandime relevante dhe të dobishme, si dhe ekzistojnë procedura për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit; Institucioni Suprem i Auditimit komunikon gjerësisht për aktivitetet dhe rezultatet e auditimit përmes mediave, faqes zyrtare të internetit dhe mjeteve të tjera, dhe i bën raportet e tij publikisht të disponueshme në kohë.

---

Ky sub-indikator i fundit fokusohet në punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Nga perspektiva strategjike dhe legjislative, analiza vlerëson nëse kornizat politike dhe ligjore parashohin përmirësime në komunikim dhe bashkëpunim me palët e jashtme të interesit, si dhe nëse transparenca e punës së NAO-së është e rregulluar qartë përmes instrumenteve si Law on the State Audit Institution dhe Rregullorja e Punës. Në praktikë, vlerësimi shqyrton disponueshmërinë dhe qasshmërinë e informacionit mbi aktivitetet vjetore të ISA-së, përfshirë nëse raportet e auditimit publikohen me kohë, janë të kuptueshme për qytetarët dhe lehtësisht të qasme online. Gjithashtu, analizohet nëse raportet e auditimit të jashtëm publikohen në formate të hapura dhe të ripërdorshme, duke mundësuar shqyrtim dhe përdorim më të gjerë nga publiku. Për më tepër, analiza merr në konsideratë efektivitetin dhe diversitetin e kanaleve që ISA përdor për komunikim të jashtëm dhe promovimin e aktiviteteve dhe gjetjeve të saj, si faqja zyrtare e internetit, rrjetet sociale dhe aktivitetet e komunikimit me publikun.

---

## Si qëndron Kosova në aspektin rajonal ?

**Sub-indikator 4:** Qasja e hapur dhe transparenca e punës së Institucionit Shtetëror të Auditimit (pikët maksimale 17)

Ky raport konfirmon se Zyrja Kombëtare e Auditimit (ZKA) të Kosovës ka një kornizë të fortë dhe të mirëpërcaktuar për transparencë, komunikim publik dhe bashkëpunim me palët e jashtme të interesit. Strategjia e Komunikimit 2023–2026<sup>34</sup> përcakton objektiva të qarta dhe aktivitete konkrete për angazhimin e publikut, mediave, shoqërisë civile, donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ajo definon përgjegjësitë në nivel të udhëheqjes së ZKA dhe Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Strategjia gjithashtu parashikon aktivitete konkrete për forcimin e bashkëpunimit me palët e jashtme të interesit, përfshirë angazhimin me media, ftesa për konferenca, punëtori dhe takime me palë të interesit, me përgjegjësi të përcaktuara qartë.<sup>35</sup>

Sa i përket kornizës ligjore, Ligji Nr. 05/L-055 në Auditimin e përgjithshëm dhe të Zyrës Kombëtare<sup>36</sup> të Auditimit rregullon në mënyrë të qartë transparencën dhe e obligon Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) të publikojë në faqen e saj zyrtare raportet e auditimit, raportet vjetore, raportet e performancës, rregulloret e brendshme dhe informacione të tjera relevante.<sup>37</sup> Ligji gjithashtu inkorporon standardet e INTOSAI-t, të cilat udhëheqin punën e ZKA.<sup>38</sup> Për më tepër, rregulloret e brendshme, si Rregullorja Nr. 01/2024 për Rekrutim dhe Karrierë, forcojnë më tej përputhshmërinë me parimet e INTOSAI-t dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke dëshmuar harmonizimin institucional me standardet profesionale të auditimit.<sup>39</sup>

<sup>34</sup> Strategjia e Komunikimit 2023–2026, faqe 15-17, i disponueshëm në [https://zka-rks.org/cms/DocumentFiles/2023\\_34bdfaec-a748-47ed-af67-1db8075c6438.pdf](https://zka-rks.org/cms/DocumentFiles/2023_34bdfaec-a748-47ed-af67-1db8075c6438.pdf).

<sup>35</sup> Strategjia e Komunikimit 2023–2026, faqe 18-19, i disponueshëm në [https://zka-rks.org/cms/DocumentFiles/2023\\_34bdfaec-a748-47ed-af67-1db8075c6438.pdf](https://zka-rks.org/cms/DocumentFiles/2023_34bdfaec-a748-47ed-af67-1db8075c6438.pdf).

<sup>36</sup> Ligji nr. 05/L-055 në Auditimin e përgjithshëm dhe Zyrën Nacionale të Auditimit, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12517&langid=2>

<sup>37</sup> Ibid.

<sup>38</sup> Ibid, Artikulli 3, paragrafi 1.8 dhe 1.9.


<sup>39</sup> Rregulloja (ZNA) Nr. 01/2024 në Rekrutimi dhe Karriera në Zyrën Nacionale të Auditimit, Artikulli 3, paragrafi 1.3 dhe 1.4, dhe artikulli 38, I disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=88977>.

Zyrja Nacionale e Auditimit publikon një gamë të gjerë raportesh auditimi dhe raportesh të performancës që janë lehtësisht të qasshme online, zakonisht të disponueshme në tri gjuhët zyrtare, dhe gjithnjë e më të dizajnuara mirë dhe të kuptueshme për qytetarët. Janë shqyrtuar dy raportet e fundit të disponueshme për të vlerësuar qasshmërinë e tyre online dhe lehtësinë e përdorimit.<sup>40</sup>

Raportet e auditimit janë të kërkueshme, përmbajnë elemente vizuale dhe publikohen rregullisht dhe me kohë. Janë shqyrtuar dhjetë raporte auditimi të publikuara në periudhën mars–shtator për këto kritere: nëse janë të kërkueshme, nëse përmbajnë përmbledhje dhe informacion kyç të kuptueshëm lehtësisht, si dhe nëse përfshijnë pjesë grafike.<sup>41</sup> Të gjitha i përmbushin këto kritere.

Megjithatë, raportet e auditimit publikohen ekskluzivisht në format PDF dhe nuk janë të disponueshme në formate të hapura, të lexueshme nga makineria, as nuk janë të qasshme përmes portalit kombëtar të të dhënave të hapura. Kjo kufizon analizën më të thelluar, krahasimin e trendeve dhe hulumtimin e bazuar në të dhëna nga gazetarët, studiuesit dhe shoqëria civile.

Për këtë sub-indikator janë intervistuar gjithashtu akterë kyç jo-shtetërorë me përvojë në këtë fushë. Nga dy që iu përgjigjën pyetjes nëse e konsiderojnë punën e ZNA si transparente, të dy janë pajtuar (ose priren të pajtohen). Të tre të intervistuarit pajtohen plotësisht se raportet e ZNA janë lehtësisht të qasshme online.




40 Raporti i Performancës ZNA, i disponueshëm në <https://zka-rks.org/AboutUs/ReportDocument>; Raporti Vjetor i Auditimit 2024, i disponueshëm në <https://zka-rks.org/Reports/ReportDetails?reportId=8096>; Raporti Vjetor i Auditimi 2023, i disponueshëm në <https://zka-rks.org/Reports/ReportDetails?reportId=8096>.

41 Zyrja Nacionale e Auditimit, të gjitha raportet të disponueshme në <https://zka-rks.org/Reports?reportSubTypeId=7>.

## Krahasimi i pikëve të përgjithshme në fushën e menaxhimit të financave publike

Indikatori: Transparenca dhe qasja e hapur e menaxhimit të financave publike



Raporti rajonal për fushën e Menaxhimit të Financave Publike, me rezultatet për të gjitha administratat e Ballkanit Perëndimor, është i disponueshëm në: [www.par-monitor.org](http://www.par-monitor.org)

### II.5 Rekomandimet në fushën e Menaxhimit të Financave Publike

#### II.5.1 Rekomandimet nga Monitorimi i RAP 2021/2022

Rekomandimet	Lloji (afatshkurtër/afatmesme/afatgjatë)	Statusi	Përshkrimi
1.Përmirësimi i transparencës në raportet buxhetore: Të përmirësohen raportet vjetore përfundimtare duke përfshirë të dhëna jofinanciare që ofrojnë informacion mbi performancën e qeverisë për secilin shfrytëzues buxhetor ose për politika specifike. Kjo do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në proceset buxhetore.	Afatshkurtër	Plotesisht e implementuar	Bazuar në monitorimin dhe të dhënat e paraqitura në këtë raport, ky rekomandim është zbatuar.

<p>2. Forcimi i angazhimit publik: Të krijohen kanale proaktive komunikimi për të angazhuar publikun në mënyrë efektive. Kjo mund të përfshijë njoftime të rregullta për media, paraqitje në media, përgatitjen e përmbledhjeve të kuptueshme të raporteve, prezencë aktive në rrjete sociale, si dhe organizimin e ngjarjeve publike me përfshirjen e akterëve jo-shtetërorë dhe shoqërisë civile. Këto masa do të përmirësojnë ndërgjegjësimin dhe kuptimin e publikut për proceset buxhetore dhe do të rrisin pjesëmarrjen publike.</p>	<p>Afatmesme</p>	<p>Pjesërisht e implementuar</p>	<p>Kërkohen ende përpjekje të mëtejshme në këtë fushë.</p>
<p>3. Promovimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile (OSHC): Të rikthehet dhe të formalizohet procesi i konsultimit me OShC-të në rregulloret e përditësuara.</p>	<p>Afatmesme</p>	<p>Nuk është ndërmarrë asnjë veprim</p>	<p>N/A</p>

## II.5.2 Rekomandimet nga Monitorimi i Raportit 2024/2025

Rekomandimet nga cikli i monitorimit 2024/2025 për fushën e Menaxhimit të Financave Publike paraqiten më poshtë. Rekomandimet janë të grupuara në tri kategori, sipas kohës së vlerësuar të nevojshme për zbatimin e tyre. Rekomandimet për të cilat koha e vlerësuar për zbatim është deri në një vit kategorizohen si afatshkurtra. Rekomandimet afatmesme pritet të zbatohen brenda një periudhe prej një deri në tre vjetësh. Rekomandimet afatgjata ka gjasa të kërkojnë më shumë se tre vjet për t'u zbatuar.

### Afatmesme

- Mbajtja e konsultimeve buxhetore më herët dhe ndarja e informacionit të plotë: Ministria e Financave duhet të organizojë konsultime publike për buxhetin përpara se të merren vendimet kyçe buxhetore, jo vetëm në fund të procesit. Dokumentet relevante duhet të publikohen me kohë dhe afatet për komente duhet të jenë reale. Kjo do t'u mundësonte organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesuara të japin kontribut kuptimplotë dhe do të përmirësonte transparencën gjatë përgatitjes së buxhetit.

### Afatshkurta

- Raportet vjetore buxhetore duhet të shpjegojnë çfarë është arritur me paratë publike: Raportet vjetore për ekzekutimin e buxhetit duhet të shpjegojnë qartë rezultatet e arritura me shpenzimet publike, veçanërisht në fushat prioritare të politikave. Ato duhet të përfshijnë gjithashtu informacion të plotë mbi investimet kapitale.

### Afatgjata

- Të bëhen të dhënat e prokurimit publik më të hapura dhe më të lehta për përdorim: Institucionet përgjegjëse për prokurimin publik duhet të publikojnë më shumë informacion mbi procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave, përfshirë të dhëna mbi konkurrencën dhe ndryshimet në kontrata. Të dhënat duhet të jenë lehtësisht të gjetshme dhe të publikohen në formate që mundësojnë analizë, në mënyrë që qytetarët, mediat dhe shoqëria civile të mund të monitorojnë siç duhet proceset e prokurimit publik.

## Shtojca e Metodologjisë

Për hartimin e këtij raporti për Kosovën, janë përdorur metodat dhe mjetet e mëposhtme kërkimore për mbledhjen e të dhënave dhe llogaritjen e elementeve:

- Analiza e dokumentacionit zyrtar, të dhënave dhe faqeve zyrtare të internetit
- Kërkesa për qasje të lirë në informacion
- Intervista me palë të interesit dhe informatorë kyç
- Anketa e perceptimit publik

Monitorimi është mbështetur në masë të madhe në analizën e dokumenteve zyrtare të publikuara në faqet e internetit të organeve të administratës dhe në të dhënat dhe informacionin e përfshirë në to. Megjithatë, në rastet kur të dhënat nuk ishin të disponueshme, hulumtuesit kanë dërguar kërkesa për qasje të lirë në informacion pranë institucioneve përkatëse, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për dhënien e pikëve për elementet.

**Tabela X.** Kërkesat e dërguara në Kosovë

Institucioni	Data e kërkesës	Data e përgjigjes së kërkesës
Ministria e Kulturës	09.09.2025	12.09.2025
Ministria e Mbrojtjes	09.09.2025	12.09.2025
Ministria e Shëndetësisë	09.09.2025	08.10.2025
Ministria e Edukimit	09.09.2025	09.10.2025
Ministria e Mjedisit, Zhvillimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	09.09.2025	N/A

Intervistat me informatorë kyç janë zhvilluar dhe janë përdorur si bazë për ndarjen e pikëve për elementet 1.5, 2.14, 3.14, 3.15 dhe 4.7. Përveç kësaj, ato janë shfrytëzuar për të mbledhur të dhëna cilësore, të fokusuara dhe të thelluara mbi fenomenet e monitoruara. Intervistat me palë të tjera të interesit (si përfaqësues të organeve të administratës publike) janë përdorur gjithashtu në hulumtim për të plotësuar dhe verifikuar të dhënat dhe gjetjet e mbledhura me metoda të tjera. Përzgjedhja e të intervistuarve është bërë përmes mostrimit të qëllimshëm, jo-probabilistik, duke synuar bashkëbisedim në bazë të ekspertizës së tyre mbi temën.

Intervistat me informatorë kyç përbëheshin nga një grup prej deri në katër pyetjesh, ku pjesëmarrësit shprehnin nivelin e pajtimit të tyre në një shkallë me katër nivele: nuk pajtohem aspak, prirem të mos pajtohem, prirem të pajtohem dhe pajtohem plotësisht. Pikët për elementet 1.5, 2.14, 3.14, 3.15 dhe 4.7 janë ndarë vetëm në rastet kur të gjithë informatorët kyç kanë deklaruar se

prirën të pajtohen ose pajtohen plotësisht me pohimin përkatës. Përveç kësaj, është përdorur edhe një set pyetjesh të hapura, që ka mundësuar diskutim me të intervistuarit dhe parashtrimin e nën-pyetjeve në moment, në vend që të ndiqej rreptësisht një format i paracaktuar. Të intervistuarve u është garantuar anonimitet i plotë sa i përket të dhënave personale dhe përkatësisë institucionale/organizative.

**Tabela X.** Intervistat e zhvilluara në Kosovë

Data	Intervistat
28.08.2025	Ekspert në fushën e Buxhetit
02.09.2025	Instituti GAP
07.10.2025	GLPS
08.10.2025	Ekspert në Fushën e Prokurimit Publik
04.09.2025	Ekspert në Fushën e Prokurimit Publik
10.09.2025	Demokracia Plus

Lista e pyetjeve të intervistuar

- **Elementi 1.5**

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 1.5. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të përgjigjeve “plotësisht pajtohem” / “prirëm të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç shprehen se pajtohen plotësisht ose prirën të pajtohen me deklaratën, ndahen 1.5 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Procesi i hartimit të buxhetit është transparent?**
  - a) nuk pajtohem aspak
  - b) prirëm të mos pajtohem
  - c) prirëm të pajtohem
  - d) plotësisht pajtohem
2. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Procesi i hartimit të buxhetit është gjithëpërfshirës?**
  - a) nuk pajtohem aspak
  - b) prirëm të mos pajtohem
  - c) prirëm të pajtohem
  - d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë të rëndësishme për të ofruar njohuri cilësore të nevojshme për vlerësimin):

1. A mund ta përshkruani përvojën tuaj, nëse keni, me pjesëmarrjen në procesin e hartimit të buxhetit?

2. Sipas mendimit tuaj, sa i hapur dhe i qasshëm është procesi i hartimit të buxhetit për akterët jo shtetërorë?

3. A keni vërejtur përmirësime apo prapambetje në transparencë ose gjithëpërfshirje gjatë viteve të fundit? Nëse po, çfarë i ka nxitur ato?

4. A mendoni se komentet dhe rekomandimet e akterëve jo shtetërorë merren parasysh gjatë procesit të planifikimit buxhetor? Ju lutem elaboroni.

- **Elementi 2.14.**

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 2.14. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të raportit të përgjigjeve “plotësisht pajtohem” / “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç shprehen se pajtohen plotësisht ose prirën të pajtohen me deklaratën, ndahen 0.75 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Buxhetet vjetore të disponueshme janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

2. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Buxhetet vjetore të disponueshme ofrojnë informacion të mjaftueshëm për qëllime kërkimore, analize dhe monitorimi të politikave?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

3. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Raportet e disponueshme për ekzekutimin e buxhetit janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Raportet e disponueshme për ekzekutimin e buxhetit ofrojnë informacion të mjaftueshëm për qëllime kërkimore, analize dhe monitorimi të politikave?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë të rëndësishme për të ofruar njohuri cilësore të nevojshme për vlerësimin):

1. Si do ta vlerësonit qasshmërinë online të buxheteve vjetore dhe raporteve të ekzekutimit? A janë të lehta për t'u gjetur dhe përdorur?
2. Sipas mendimit tuaj, a e mbështet formati dhe struktura e dokumenteve të publikuara buxhetore kuptimin dhe analizën nga persona jo-ekspertë?
3. Çfarë lloj informacioni mendoni se mungon ose është i pamjaftueshëm në buxhetet vjetore apo raportet e ekzekutimit të disponueshme?
4. A i keni përdorur ju apo organizata juaj dokumentet buxhetore të publikuara për kërkime, avokim apo monitorim? Nëse po, sa të dobishme kanë qenë ato?
5. A keni hasur ndonjë sfidë gjatë përpjekjeve për të qasur apo kuptuar dokumentacionin buxhetor? Nëse po, mund t'i përshkruani ato?

- **Elementi 3.14.**

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 3.14. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të raportit të përgjigjeve “plotësisht pajtohem” / “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç shprehen se pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me deklaratën, ndahen 1.5 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Sistemi i prokurimit publik, ashtu siç është i përcaktuar me legjislacionin për prokurimin publik, është transparent?**
  - a) nuk pajtohem aspak
  - b) prirem të mos pajtohem
  - c) prirem të pajtohem
  - d) plotësisht pajtohem
2. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Sistemi i prokurimit publik, ashtu siç është i përcaktuar me legjislacionin për prokurimin publik, është konkurrues?**
  - a) nuk pajtohem aspak
  - b) prirem të mos pajtohem
  - c) prirem të pajtohem
  - d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë të rëndësishme për të ofruar njohuri cilësore të nevojshme për vlerësimin):

1. Bazuar në përvojën tuaj, si do ta përshkruanit nivelin e përgjithshëm të transparencës së sistemit të prokurimit publik në nivel qendror?
2. A mendoni se korniza aktuale ligjore dhe institucionale siguron konkurrencë të drejtë në prokurimin publik?

3. A keni vërejtur praktika ose modele të zakonshme që e ulin transparencën dhe konkurrueshmërinë në procedurat e prokurimit?

4. A ekzistojnë mekanizma që mundësojnë mbikëqyrje kuptimplotë ose kontroll publik të proceseve të prokurimit? Nëse po, sa efektivë janë ata?

- **Elementi 3.15**

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 3.15. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të raportit të përgjigjeve “plotësisht pajtohem” / “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç shprehen se pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me deklaratën, ndahen 1.5 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Ligji për prokurimin publik rregullon në mënyrë të përshtatshme përgjashtimet nga zbatimi i tij?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

2. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Përgjashtimet nga zbatimi i ligjit për prokurimin publik, në praktikë, kufizohen vetëm në ato të parashikuara me ligj?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë të rëndësishme për të ofruar njohuri cilësore të nevojshme për vlerësimin):

1. Si do ta vlerësonit qartësinë dhe përshtatshmërinë e dispozitave ligjore që rregullojnë përgjashtimet nga ligji për prokurimin publik?

2. Sipas përvojës suaj, a zbatohen përgjashtimet brenda kornizës ligjore, apo ka raste kur përdoren më gjerësisht se sa parashihet me ligj?

3. A mendoni se përdorimi i përgjashtimeve është rritur apo zvogëluar me kalimin e kohës? Cilat faktorë mund ta kenë ndikuar këtë trend?

4. A ekzistojnë mekanizma të mjaftueshëm mbikëqyrës ose kontrolli për të monitoruar përdorimin e përgjashtimeve në prokurimin publik?

5. Çfarë reforma ose masa mbrojtëse do të rekomandonit për të siguruar që përgjashtimet të përdoren në mënyrë të duhur dhe të mos cenojnë integritetin e prokurimit publik, transparencën apo konkurrencën?

- **Elementi 4.7.**

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 4.17. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të raportit të përgjigjeve “plotësisht pajtohem” / “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç shprehen se pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me deklaratën, ndahen 1.5 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Puna e Institucionit Suprem të Auditimit është transparente?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

2. Në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: **Raportet e Institucionit Suprem të Auditimit janë lehtësisht të qasshme online?**

- a) nuk pajtohem aspak
- b) prirem të mos pajtohem
- c) prirem të pajtohem
- d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë të rëndësishme për të ofruar njohuri cilësore të nevojshme për vlerësimin):

1. Si do ta vlerësonit transparencën e përgjithshme të punës së Institucionit Suprem të Auditimit, përfshirë praktikat e auditimit dhe raportimit?

2. Sipas përvojës suaj, sa e lehtë është qasja në raportet e Institucionit Suprem të Auditimit online? A publikohen ato me kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për përdoruesit?

3. A e konsideroni përmbajtjen dhe strukturën e raporteve të Institucionit Suprem të Auditimit të përshtatshme për të kuptuar gjetjet dhe rekomandimet kryesore?

4. A mendoni se Institucioni Suprem i Auditimit angazhohet mjaftueshëm me shoqërinë civile, mediat apo publikun për të komunikuar punën dhe gjetjet e tij?

Anketa e perceptimit publik bazohet në një pyetësor që synon publikun e përgjithshëm (banorë të përhershëm 18+ vjeç) të Kosovës. Anketa është realizuar përmes intervistimit telefonik të asistuar me kompjuter, në kombinim me intervistimin online të asistuar me kompjuter. Anketa është zhvilluar nga 1 shkurti deri më 26 shkurt 2025. Marzhi i gabimit për mostrën prej 1007 qytetarësh është  $\pm 3.52\%$ , në nivel besueshmërie prej 95%.

**Tabela X.** Pyetjet e anketës së perceptimit publik në fushën e Menaxhimit të Financave Publike

Deklarim 20	Nuk pajtohem aspak	Prirem të mos pajtohem	Prirem të pajtohem	Plotësisht pajtohem	Nuk e di/ Nuk kam opinion
Unë kam mundësinë të ndikoj në mënyrën se si shpenzohen mjetet nga buxheti i shtetit.	26.1	34.9	28.9	6	4.7
Deklarim 21	Nuk pajtohem aspak	Prirem të mos pajtohem	Prirem të pajtohem	Plotësisht pajtohem	Nuk e di/ Nuk kam opinion
Autoritetet shtetërore publikojnë informacione mbi mënyrën se si shpenzohen mjetet nga buxheti i shtetit.	20.5	30.6	34.8	8.7	5.4

## Lista e Burimeve të Referuara në këtë Raport

OECD (2023), Parimet e Administratës Publike, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/7f5ec453-en>.

SIGMA (2024), Raporti I Administratës Publike në Kosovë, [https://www.sigmaweb.org/content/dam/sigma/en/publications/reports/2025/01/public-administration-inkosovo-2024\\_d9378da9/a53fce6b-en.pdf](https://www.sigmaweb.org/content/dam/sigma/en/publications/reports/2025/01/public-administration-inkosovo-2024_d9378da9/a53fce6b-en.pdf)

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026, <https://kryeministri.rks-gov.net/wpcontent/uploads/2023/03/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike.pdf>.

Ligji Nr. 08/L-260 në ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85052>.

Ligji Nr. 08/L-332 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>.

Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12517>.

Rregullorja (ZKA) No. 01/2024 për Rekrutimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=88977>.

Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritetin Publiko-Privat, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2784>.

Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qëndrore të Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2696>.

Ministria e Financave, Broshura Informuese për Qytetarët 2025, <https://mfpt.rks-gov.net/Buxheti/Page/329>.

Ministria e Financave, Seria Mujore Fiskale, e disponueshme në <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>.

Ministria e Financave, Raporti Gjashtëmujor 2025, i disponueshëm në <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/33>.

Ministria e Financave, Raporti Financiar Nëntëmujor 2025, I disponueshëm në <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/33>.

Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik, Raporti Vjetor 2024, [https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti\\_Vjetor\\_KRPP\\_2024\\_ALB\\_431d89dd59.pdf](https://krppcms.rks-gov.net/uploads/Raporti_Vjetor_KRPP_2024_ALB_431d89dd59.pdf).

Zyrja Kombëtare e Auditimit, Strategjia e Komunikimit 2023–2026, [https://zka-rks.org/cms/DocumentFiles/2023\\_34bdfaec-a748-47ed-af67-1db8075c6438.pdf](https://zka-rks.org/cms/DocumentFiles/2023_34bdfaec-a748-47ed-af67-1db8075c6438.pdf).

Zyrja Kombëtare e Auditimit, Raporti Vjetor i Auditimit 2024, <https://zka-rks.org/Reports/ReportDetails?reportId=8096>;

Zyrja Kombëtare e Auditimit, Raporti Vjetor i Auditimit 2023, <https://zka-rks.org/Reports/ReportDetails?reportId=8096>.



Funded by  
the European Union

With funding from  
 Austrian  
Development  
Agency

---

Produced within Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0 project. WeBER 3.0 is implemented by Think of Europe Network - TEN and Centre for Public Administration Research – KDZ.

WeBER 3.0 is funded by the European Union and the Austrian Development Agency - ADA. Views and opinions expressed are however those of the authors only and do not necessarily reflect those of the European Union or ADA. Neither the European Union, ADA, TEN nor KDZ can be held responsible for them.

For more information, please visit [www.par-monitor.org](http://www.par-monitor.org).